



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2022:139138

Datë: 11.08.2022

Numri i dokumentit: 03320252

P.nr.247/22

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, DEGA NË VUSHTRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Nazmije Maxhera në çështjen penale kundër të pandehurit G. L. nga V., të cilin e përfaqëson sipas detyrës zyrtare Av. Valdet Kadriu, për shkak të veprës penale *Kanosje* nga neni 181 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1221/22 të dt:05.07.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar më dt.09.08.2022, në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av.Valdet Kadriu, e në mungesë të prokurores se shtetit, ne te njëjtën ditë morri dhe shpalli, ndërsa me datë 12.08.2022 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: G. L., nga babai F. dhe nëna L., e gjinisë G., i lindur me datë 22.11.2000, në Vushtri, me vendbanim në rrugën “J.D. R.”, nr., në V. me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili gjendet në paraburgim nga data 10.06.2022 prej orës 14:45 minuta,

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

SEPSE: me daten 10.06.2022 rreth ores 13:26 ne rr."Sh.I." pn, V. perballe mobil-shopit "F.", seriozisht kanos me fjale dhe gjeste personin tjetër se do ta privoj nga jeta, ose do t'i shkaktoj lendime te renda trupore me qellim te frikesimit ose brengosjes, ashtu qe fillimisht te demtuarit Ardi Merovcit, te cilin ne ditën kritike e takon perballe dyqanit te tij M.-sh. "F." dhe ne pyetjen e te demtuarit “Pse po me shikon, a te kam borxh”, i dvshuari i pergjigjet " Sikur te kisha pas borxh isha ardhe ne shtepine tende dhe ta kisha derdhe trunin ne toke, ta q.. .. familjen, te plasi” , me ç’rast giate gjithë kohes e mbante doren ne brez, andaj i demtuari dyshonte se ka ndonie arme, pas kesaj vjen K. R., polici ne civil i cili ishte jashte detyres zyrtare, e sheh turmen dhe menjehere e thirre patrullen policore, ndersa te pandehurit ia tregon kartelen zvrtae le legiitimimit. pastaj arrin patrulla policore dhe e shoqeron te pandehurin ne stacion dhe te demtuarin, ndersa i pandehuri me rastin e marrjes ne pyetje eshte siellur ne menyre arrogante ndai policeve te pranishem, i kanoset K.R. “une do te ankothem kunder policit, une dhe familja ime te gjithë kemi qene ne UCK, une dy here i kam plagosur personat te tjere, keni me pa kush jam une”, duke menduar dhe duke biseduar per te demtuarin Kushtrimin, ndersa patrulla policore gjate vend-shiqimit. jo larg vendit ku ka ndodhur vepra, gjene nje thike te gjate 28 cm, me tehe te gjate 13 cm, per te cilin i pandehuri pranon se eshte i tij dhe gjate gjithë kohes e ka mbajtur ne brez, e para se me arrit policia e ka hedhur ne rruge, andai te demtuarit per shkak te kanosies se cekur dhe dyshimit se i pandehuri ka ndonje arme me vete, jane frikesuar per jeten e tyre me clhe ieten e familjeve te tyre.

Me çka ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 7, 17, 38, 40, 42, 69, 70 dhe nenit 181 par.2 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 453 dhe 463 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME BURGIM

- I. Me të cilin dënim të pandehurit **G. L.** gjykata i cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajsh**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- II. Në dënimin e shqiptuar te pandehurit do ti llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga data 10.06.2022 e deri më datë 09.08.2022.
- III. **DETYROHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30(tridhjetë) euro** dhe në emër të kompensimit të fondit për viktimat e krimit të paguaj shumë prej **30 (tridhjetë) euro**.
- IV. Për realizimin e kërkesës pasurore juridike palët e dëmtuara udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1221/22 të dt:05.07.2022, ndaj të pandehurit G. L. nga V., të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare Av. Valdet Kadriu, për shkak te veprës penale *Kanosje* nga neni 181 par.2 të KPRK-së. Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj të pandehurit G. L. me aktvendimin PPR.nr.59/22, të datë 12.06.2022, me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kishte caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues këtë masë ia kishte vazhduar edhe për një muaj tjetër të pandehurit me aktvendimin P.nr.247/22, të datë 08.07.2022.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me datë 09.08.2022, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Slavica Mavric, i pandehuri G. L. dhe mbrojtësi i të pandehurit av.Valdet Kadriu.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 09.08.2022, pasi që gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë ku i pandehuri ka deklaruar se e **pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës**.

Pas pranimin të fajësisë, gjykata paraprakisht e ka njoftuar të pandehurin lidhur me benefitet e pranimin të fajësisë, ndërsa ia ka tërhequr vërejtjen edhe lidhur me pasojat e pranimin të fajësisë.

Ashtu që të njëjtin e ka njoftuar për dënimet e parapara për veprën penale *Kanosje* nga neni 181 par.2 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata e ka njoftuar të pandehurin se me pranimin e fajësisë nuk do të mund të kundërshtojë provat apo të parashtrij prova në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojë vendimin për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarimin mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese.

I pandehuri edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, ka deklaruar se dëshiron ta pranoj fajësinë dhe ka shtuar se ngjarja ka qenë e çastit, i vije keq për atë se çfarë ka ndodhur, ka kërkuar falje dhe kërkim falje është pranuar, ka premtuar se kjo është hera e fundit që vije në gjykatë dhe në të ardhmen nuk do të bëjë as gjënë më të vogël të kundërligjshme dhe gjithashtu edhe gjykatës i ka kërkuar falje.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Valdet Kadriu, lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi i tij është bërë pa presion, në mënyrë vullnetare andaj i ka propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë së të pandehurit, e që me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese si shprehjen e keqardhjes nga i pandehuri, rrethanat personale të të pandehurit pasi që ai nuk është kryes i veprave penale me aktgjykim të plotfuqishëm, moshën e re të tij, ku i pandehuri është në moshën 21 vjeçare e që për disa persona në këtë moshë ende nuk është arritur pjekuria, sjelljen e të pandehurit pas konfliktit pasi që i njëjti është pajtuar me palën e dëmtuar, si dhe faktin e provokimit nga ana e viktimës pasi që i njëjti i kishte thënë “ Pse po më shikon?”. Andaj mbi këto arsye e ka lutur gjykatën që të pandehurit ti jap një dënim me gjobë apo dënim të kushtëzuar, e gjithashtu ka propozuar që të pandehurit ti ndërpritet masa e paraburgimit, për shkak se kanë pushuar kushtet për vazhdimin e saj.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që pranimi është bërë në baza vullnetare, pa presioni, dhe duke marrë parasysh faktin se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në faktet dhe provat të cilat i përmban aktakuza dhe tutje i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese. Gjithashtu i ka propozuar gjykatës që ndaj të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimit, pasi që i njëjti është pajtuar me të dëmtuarin dhe ka premtuar se nuk do të përsëris më vepra të tilla penale.

Gjykata duke marrë parasysh deklarimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar, dhe mare parasysh aktpajtimin me palën e dëmtuar dhe familjen e tij, të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 29.07.2022, dhe pranimin e fajësisë nga i pandehuri, me aktvendimin P.nr.247/22, të datë 09.08.2022, i ka ndërprerë masën e paraburgimit të pandehurit.

Provat e vlerësuara nga gjykata

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 248 të KPP-së, dhe ka konkluduar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovet nga ana e gjykatës.

Gjykata ka pranuar deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-BD-505, i datë 10.06.2022, raporti policor me numër të rastit 2022-BD-505, i datë 10.06.2022, raporti i oficerit i datë 10.06.2022, raporti policor i datë 10.06.2022, raporti policor i datë 13.06.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin A.M. i datë 10.06.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin G. L. i datë 10.06.2022, foto-dokumentacioni në pesë shtojca si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale të cilën e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69 dhe 70 të KPRK-së, ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, moshën e re të pandehurit pasi që i njëjti është 21 vjeçar, kërkim faljen e të pandehurit drejtuar të dëmtuarit dhe gjykatës, premtimin e dhënë gjykatës se asnjëherë nuk do të përsëriten më veprime të tilla, faktin se në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit nuk ka më asgjë të keqe dhe i dëmtuari ka pranuar kërkim faljen nga i pandehuri, seancën gjyqësore i pandehuri e ka përcjell me vëmendje të theksuar, si dhe ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit. Kurse sa iu përket rrethanave renduese gjykata mori parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përgjegjësinë penale të kryesit pasi vepra është kryer me dashje, rrethanat në të cilat është kryer vepra duke marr parasysh edhe sjelljen arrogante nga ana e të pandehurit ndaj zyrtarit policor, posedimin e mjeteve të rrezikshme nga i pandehuri me të cilat mund të rrezikoj jetën e njerëzve, faktin se i pandehuri është i njohur për gjykatën dhe ndaj ti zhvillohen procedura edhe për vepra të tjera penale.

Së këndejmi me pranimin e gjitha këtyre rrethanave, duke u bazuar në dispozitën e nenit 181 par.2 të KPRK-së, ku për veprën penale *Kanosja*, parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit, e në vështrim të dispozitave të neneve 17, 38, 40, 42, 69, 70 dhe nenit 181 par.2 të KPRK-së, nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim më i rëndë dhe sidomos dënim më i butë, pasi që për shkak se ndaj të pandehurit është duke u zhvilluar procedura penale edhe për lëndë të tjera dhe me një vështrim në informacionet e personit nga Policia e Kosovës mund të shihet se i pandehuri është i përfshirë si i dyshuar në një numër të konsiderueshëm të veprave penale madje edhe me peshë të rëndë, gjykata u bind se për rehabilitimin dhe risocializimin e të pandehurit si disa nga qëllimet e dënimit, dënimi me burgim si në dispozitiv në këtë aktgjykimi është i domosdoshëm.

Andaj, gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim me burgim ndaj të pandehurit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandaloje personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.2, vendimin për shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 nën par 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 365 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr. 247/22 dt. 12.08.2022

Zyrtarja ligjore
Nazmije Maxhera

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.